

Në bazë të Kontratës nr. 401-01-00023/2019-01 të nënshkruar më 28.06.2019 mes Kabinetit të ministrit pa portofol të Republikës së Serbisë, të autorizuar për inovacione dhe zhvillim teknologjik dhe mes Komunës së Preshevës, mbi realizimin e projektit “Inovacioni në vepër” dhe Vendimit të Këshillit komunal të Komunës së Preshevës mbi mënyrën dhe procedurën e realizimit të projektit “Inovacioni në vepër” nr. 401-6 të datës 12.08.2019, Administrata komunale e komunës së Preshevës, Zyra për zhvillim ekonomik lokal shpallë më 16.08.2019 këtë:

T H I R R J E P U B L I K E

për pjesëmarrje në Programin e trajnimeve për inicimin e biznesit / avancimin e biznesit dhe ndarjen e mjeteve të pakthyeshme grave për zhvillimin e inovacionit, në kuadër të projektit “Inovacioni në vepër”

Projektin “Inovacioni në vepër” bashkëfinancohet nga Kabineti i Ministrit pa portofol i ngarkuar për inovacion dhe zhvillim teknologjik i Republikës së Serbisë dhe Komuna e Preshevës.

Qëllimi i projektit “Inovacioni në vepër” është avancimi i subjekteve ekonomike ekzistuese, poashtu edhe i atyre të reja të cilat janë në pronësi të grave, por edhe krijimin e parakushteve dhe klimës afariste për zhvillim të vazhdueshëm të ndërmarrësisë së grave dhe inovacionit në komunën e Preshevës. Realizimi i projektit duhet të kontribuojë në krijimin e klimës pozitive për zhvillimin e ndërmarrësisë inovative. Përkrahja është e orientuar ndaj grave të papunësuar, grave pronare të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe ndaj ndërmarrëseve.

Përmes ofrimit të ndihmës jofinanciare dhe financiare, ky program do të mbështesë zhvillimin e ndërmarrësisë dhe ideve inotvativ dhe ideve inotvative të grave nëpërmjet:

- edukimit për fillimin dhe udhëheqjen e biznesit, në formë të trajnimit për fillimin dhe avancimin e biznesit,
- garës për biznes planin më të mirë,
- ndihmës së pakthyeshme për finasimin e biznes planeve më të mira,
- realizimit të programit të mentorimit, i cili ka për qëllim përkrahjen e ndërmarrjeve dhe ndërmarrëseve, të cilat gjenden në momentin kritik për zhvillimin e mëtutjeshëm të tyre apo ekzistimin në përgjithësi;

Kushtet për pjesëmarrje në projekt

Projekti për nxitjen dhe zhvillimin e ndërmarrësisë inovative përmes përkrahjes jofinanciare për gratë e papunësuar, gratë pronare të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe ndaj ndërmarrëseve, realizohen sipas Programit të “Inovacionit në vepër” (teksti në vijim: *Programi*), të cilin e ka përgatitur komuna e Preshevës.

Përparësi në përfitimin e mjeteve të pakthyeshme në kuadër të projektit, kanë kandidatet të cilat nuk kanë përfituar mjete të pakthyeshme (subvencione) nga komuna e Preshevës në vitin 2018 dhe 2019.

Programi realizohet në dy faza:

- Faza I-rë e programit – Trajnime
- Faza II-të e programit – Ndarja e mjeteve të pakthyeshme

Kushtet e përgjithshme për pjesëmarrje në program

Faza e parë e programit - Trajnime:

1. Gratë e papunësuara

- që kanë ide inovative për ndërmarrësi dhe dëshirë të fillojnë punë;
- që kanë vendqëndrim në territorin e komunës së Preshevës, më së paku 6 muaj para shpalljes së thirrjes;
- të cilat nuk janë të dënuar për vepër penale kundër ekonomisë dhe vepra penale kundër pasurisë,
- që janë të evidentuar në Shërbimin Nacional për Punësim si të papunësuara.

2. Gratë pronare të ndërmarrjeve mikro, të vogla, dhe të mesme si dhe gratë ndërmarrëse;

- të cilat posedojnë shumicën e pronësisë së mikrondërmarrjeve ose themelues tëveprimtarive sipërmarrëse;
- të cilat kanë vendqëndrim në territorin e komunës Preshevë;
- të cilat nuk janë të dënuar për vepër penale kundër ekonomisë dhe vepra penale kundër pasurisë, si dhe shoqërit ekonomike në pronësi të tyre nuk janë të dënuar për vepra penale kundër ekonomisë dhe vepra penale kundër pasurisë.
- të cilat duan të avancojnë veprimtarinë e tyre përmes zhvillimit të inovacionit
- të cilat e kanë të regjistruar ndërmarrjen në APR (Agjencionin e regjistrave ekonomik), e cila ka selinë në territorin e komunës së Preshevës dhe ka status aktiv

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim në fazën e I-rë:

1. Gratë e papunësuara:

- Formulari për aplikim për pjesëmarrje në programin e trajnimeve (Formulari 1)
- Deklarata mbi vërtetësinë e të dhënave të paraqitura (Formulari 1a);
- Letërnjoftimi i lexuar (për gratë e papunësuara);
- Vërtetimin që gjendet në evidencën e Shërbimit nacional për punësim;

2. Gratë pronare të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe gratë ndërmarrëse:

- Formulari për aplikim për pjesëmarrje në programin e trajnimeve (Formulari 2);
- Deklarata mbi vërtetësinë e të dhënave të paraqitura (Formulari 2a);
- Ekstrakti nga APR jo më i vjetër se 90 ditë nga dita e shpalljes së thirrjes publike.
-

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim në fazën e II-të për të dy grupet:

- Biznes plani (formulari 3),
- Tri oferta / profatura të furnitorëve të pajisjeve / ofruesit e shërbimeve për të cilin furnizim po aplikohet (3 oferta për çdo furnizim veçmas për të mjete / shërbime; psh. 3 oferta për modelin identik / tipi i prodhimit / shërbimit).

Përmes programit parashihet që kandidatet e ranguar më lartë para paraqitjes së aplikacionit për fazën e dytë, e ndjekin trajnimin **“Hyrje në inovacion”**

Të drejtë pjesëmarrjeje në Program në fazën e dytë të ndarjes së mjeteve të pakthyeshme biznes planeve më të mira, kanë ato kandidatet të cilat me sukses kanë vijuar trajnimin për fillimin/avansimin e biznesit dhe kanë përpiluar biznes planin.

Pas realizimit të garës me biznes planin më të mirë, biznes planet e ranguar më lartë, do të kualifikohen për ndarje të mjeteve të pakthyeshme. Kandidatet janë të obliguar që përmes biznes planit të përpilojnë idenë e tyre afariste, me të cilën kanë kandiduar në fazën e parë të Programit.

Kushti për ndarjen e mjeteve të pakthyeshme është regjistrimi i biznesit në Agjencionin e regjistrimit ekonomik (APR) (të shoqërisë ekonomike/ndërmarrjes – për gratë e papunësuar).

Përfituesit e mjeteve të pakthyeshme obligohen që veprimtarinë e regjistruar, për të cilën u janë ndarë mjetet e pakthyeshme, të mbajnë më së paku një vit, nga data e nënshkrimit të kontratës mbi ndarjen e mjeteve të pakthyeshme.

Mjetet e përgjithshme të disponueshme për të dy grupet arrijnë shumën prej 2.400.000 dinarësh, me vlerë maksimale prej 240.000 dinarësh për përfituese.

Vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikacioneve e bën Komisioni për realizimin e thirrjes publike në bazë të kriterëve për vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikacioneve, të cilët gjenden në dokumentacionin përcjellës të thirrjes publike dhe e përbëjnë pjesën përbërëse të tij.

DEDIKIMI I MJETEVE TË PAKTHYESHME

Projektet e pranueshëm:

- inovacioni i prodhimeve, si zbatim i prodhimit të ri apo dukshëm të përmirësuar, ku prodhimi i ri që ndërlidhet me personin juridik (nuk duhet patjetër të jetë prodhim i ri për treg), por nuk është vetëm ndryshim i natyrës estetike ose veçanërisht shitja e prodhimeve të inovuara, të cilat i ka prodhuar dhe zhvilluar personi tjetër juridik;
- inovacioni i procesit, si zbatim i mënyrës së re të prodhimit apo dukshëm të përmirësuar ose të distribuimit (përfshirë ndryshime të dukshme në teknikë, pajisje ose softuer, por jo veçanërisht ndryshime organizative dhe menaxheriale), e cila është e re apo e avancuar për personin e juridik, pa marrë parasysh se kush e ka zhvilluar atë;
- inovacioni i organizimit, si zbatim i ndryshimeve të reja apo dukshëm të përmirësuar në strukturë ose metodën e menaxhmentit, me qëllimin që ndaj personit juridik të përmirësohet përdorimi i njohurive, kualitetit të prodhimit apo shërbimit, ose të rritet efikasiteti i rrjedhave afariste (biznesore);
- inovacioni në marketing, si zbatim i metodës së re të marketingut, duke përfshirë ndryshime të dukshme në dizajnin e prodhimit, paketimin, tregun dhe promovimin dhe faturimin e prodhimeve;

Aktivitetet e projektit të cilat nuk do të financohen

Mjetet sipas këtij programi nuk mund të shfrytëzohen për:

- Adaptimi/rekonstruimi i hapësirës punuese;
- Blerja/sigurimi e lëndës së parë;
- Organizimin e lojrave të fatit, lotarive dhe veprimtarive të ngjajshme;
- Prodhimin dhe qarkullimin e çfarëdo prodhimi ose aktiviteti të cilat sipas dispozitave vendore ose me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, konsiderohen të ndaluara;
- Tregëtinë e naftës dhe derivateve të naftës;
- Prodhimin primar bujqësor;
- Çfarëdo lloji i veprimtarisë tregtare dhe hotelierisë;
- Aktivitete që kanë të bëjnë me parti politike.

Përmes programit financohen shpenzimet e pranueshme të aktiviteteve të projektit (të cekura më lartë), të cilat janë pjesë përbërëse e kontratës, të cilat realizohen pas nënshkrimit të Kontratës me komunën.

Pajisjet në kuptimin e këtij programi nënkuptojnë: sistemet, makinat dhe pajisjet përcjellëse, të cilat mund të jenë:

- Investimet në blerjen e makinave dhe paisjeve (do të financohen veçanërisht blerja e pajisjeve të reja, të blera nga personat juridik të regjistruar në territorin e Republikës së Serbisë)

Mjetet e pakthyeshme do të aprovohen për blerjen e të mirave materiale/ shërbimeve për realizimin e idesë së biznesit, që do të shpërblehet në kuadër të kësaj gare.

Një aplikuese mund të dorëzojë vetëm një aplikacion

MËNYRA E APLIKIMIT DHE AFATET PËR DORËZIMIN E APLIKACIONEVE:

Thirrja publike është shpallur më 16.08.2019 në web-faqen e komunës së Preshevës www.presevo.rs. Afati për dorëzimin e aplikacioneve për pjesëmarrje në trajnim për fillimin / avancimin e biznesit dhe hyrje në inovacion është më 30.08.2019 deri në ora 14:00. Aplikacioni duhet të plotësohet në mënyrë elektronike, në të kundërtën nuk do të merret në shqyrtim.

Afati për dorëzimin e aplikacionit në kuadër të fazës së dytë të Programit (Biznes planit) është i kushtëzuar me realizimin e trajnimeve për fillimin/avancimin e biznesit, gjegjësisht 14 ditë pas kryerjes së trajnimeve, ndërsa aplikuesit në fazën e garimit, për të njëjtën do të jenë të njoftuar me kohë.

Aplikacioni i printuar dhe nënshkruar me dokumentacionin e obligueshëm, dorëzohet në zarf të mbyllur me mbishkrimin: “Thirrja publike për pjesëmarrje në projekt “Inovacioni në vepër” – mos e hap”, personalisht nëpërmjet Shkresores së Administratës komunale, të cilat do të evidentohen me numër të veçantë protokoli një nga një, drejtuar Komisionit për realizimin e projektit “Inovacioni në vepër”.

Për informata më të hollësishme mund t’i drejtoheni Komunës së Preshevës:

Telefoni: +381 17 715 1017
e-mail: s.musliu@presevo.rs